



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 26, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 1.2 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, mori këtë

### **V E N D I M**

#### **PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “SPORT MARKETING” SHA, NË PRISHTINË**

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ndërmarrjes publike lokale “Sport Marketing” SHA, në Prishtinë, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij propozimi, është:
  - 1.** Fushat e tenisit, të cilat shtrihen në parcelat kadastrale nr. P-71914059-02477-0, P-71914059-02478-0, P-71914059-02494-0, P-71914059-02495-0, P-71914059-02496-0 dhe P-71914059-02497-0. Zona kadastrale Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhënie në shfrytëzim e pronës komunale, e cila është kërkuar nga NPL “Sport Marketing” SHA, në Prishtinë.
- IV.** Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të fushave të tenisit, të cilat shtrihen në parcelat kadastrale nr. P-71914059-02477-0, P-71914059-02478-0, P-71914059-02494-0, P-71914059-02495-0, P-71914059-02496-0 dhe P-71914059-02497-0. Zona kadastrale Prishtinë, në pronën e paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është (10) dhjetëvjeçar, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.
- V.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- skica grafike,
  - kopja e planit dhe certifikata e pronës.
- X.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-463/02-112373/21, më 16.06.2021**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

